



## 16-22 Shtator Java Europiane e Lëvizshmërisë



*Ju bëjmë thirrje dhe ftojmë të gjithë qytetarët, punonjësit e administratës, shkollat dhe bizneset të inkurajohen në lëvizshmërinë me “zero” ndotje nëpërmjet ecjes, përdorimit të biçikletave si dhe mjeteve të tjera ekologjike të transportit për të mbrojtur mjedisin ku jetojmë.*

Kjo javë synon çështjet e lëvizshmërisë si dhe transportin urban duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë të jetës dhe shëndetit të njerëzve.

Shkarkimet nga automjetet dhe transporti urban kanë kontributin kryesor në ndotjen e ajrit. Llojet e grimcave ndotëse, gazrat toksike që rrjedhin nga djegia e lëndëve djegëse për transportin përveç ndotjes së ajrit urban shkaktojnë edhe efekte negative në shëndetin e njerëzve. Kjo fushatë është një mundësi për të paraqitur alternativa të qëndrueshme të lëvizshmërisë për qytetarët dhe për të bërë të njohur sfidat me të cilat ndeshen qytetet për të ndryshuar sjelljen e njerëzve drejt një strategjie më të qëndrueshme të transportit.

